



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2634/prot.

Tiranë, më 21.10 2020

3

VENDIM

Nr. 31, datë 21.10.2020

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, të UT-së, për vitin akademik 2020-2021”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma f; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë me shkresën nr. 545 Prot., datë 17.09.2020, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 21.10.2020;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë për ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2020-2021, në:
 - “Bachelor” në “Histori”;
 - “Master i Shkencave” në “Histori”;
 - “Master i Shkencave” në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”;
 - “Master Profesional” në “Mësuesi në Histori për Arsimin e Mesëm”;
 - “Master Profesional” në “Arkivistikë”;
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Artan Hoxha